

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria**
(zgjidhjet)

P10

Nr.

FLETË PROVIMI

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Data 01/10/2016

Detyra 1

Ju jeni menaxher i auditimit në firmën e auditimit ASKA. Ju keni përgjegjësi specifike për të ndërmarrë rishikime vjetore të klientëve ekzistues dhe të këshilloni nëse një angazhim mund të vazhdohet në mënyrë të përshtatshme. Çështjet në vijim janë paraqitur në lidhje me angazhimet e fundit:

- (a) Arben Hito, senior i auditimit është përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të Morena, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015. Drejtori ekzekutiv i Morena, Burim Baci, sapo ju ka dërguar një email për të ju informuar se Arbeni është në listën e ngushtë të kandidatëve për pozitën e drejtorit financiar të Morena. Ju nuk ishit në dijeni se Arbeni kishte aplikuar për këtë pozitë. **(7 pikë)**
- (b) Katrani, një ShPK, është klient tashmë një kohë të gjatë. Njëra nga degët e kësaj kompanie, Alfa, ka krijuar humbje për disa vite. Sipas kërkesës së firmës tuaj, menaxhmenti i Katrani ka bërë përfaqësime të shkruara (letra e përfaësimit) se goodwill që është gjeneruar nga blerja e Alfa, nuk është dëmtuar (nuk ka humbur në vlerë). Raporti i auditimit i firmës tuaj që ishte lëshuar për Katrani për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015 ishte me opinion pa rezervë. Poashtu edhe opinioni për degën e Katrani, Alfa ishte pa rezervë për vitin e njëjtë. Drejtori ekzekutiv i Katrani, Avni Kika, do të pensionohet në vitin 2016 në të cilin vit edhe opsionet e aksioneve të tij do të maturohen. **(8 pikë)**
- (c) Korbi, një ShPK i cili është klient i auditimit, ka kërcënuar se do të padisë firmën tuaj sa i përket tarifave që i janë ngarkuar për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015. Korbi pohon se firma e juaj ka ngarkuar tarifa të plota të biletave aeroplanit për stafin e auditimit edhe pse ato bileta ishin blerë me një zbritje shumë të madhe nga aviokompania. **(5 pikë)**

Kërkohet

Komentoni mbi çështjet etike dhe profesionale të ngritura nga secili rast më sipër dhe komentoni implikimet (nëse ka) për vazhdimin e secilit angazhim.

(Total 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Morena

Pavarësia

Pasi që është në listën e ngushtë të të përzgjedhurve për drejtor financiar, Arbeni nuk është më i pavarur sa i përket auditimit të Morena. Është një rrezik i madh që Arbeni duke dashur të impresionoj sa më shumë punëdhënësit e ardhshëm të ndikojë në auditimin të cilin do ta kryejë.

Procedurat e kontrollit të cilësisë

Kodi i etikës i IFAC thekson se një firmë duhet të ketë politika të kontrollit të cilësisë që thuhet se nëse një anëtar senior i stafit të auditimit i cili ka mundësi të punësohet te klienti i auditimit, atëherë anëtari i stafit duhet ta shpalos këtë fakt në firmën e auditimit.

Në këtë rast ose firma e auditimit ASKA nuk e ka një politikë të tillë e cila është një dështim në kontrollin

e saj të kualitetit ose e ka një politikë të tillë dhe Arbeni e ka shlelur këtë politikë duke mos treguar se ka aplikuar për punë në kompaninë Morena.

Pa marrë parasysh nëse ASKA e ka një politikë të tillë, është çështje integritetit personal të Arbenit i cili është dashur ta shpalos një fakt të tillë sepse është dashur të jetë i vetëdijshëm se nuk mund të jetë i pavarur nga auditimin e Morena.

Arbeni duhet të qortohet nga punëdhënësi i tij për këtë sjellje.

Implikimet për vazhdimin e angazhimit

Arbeni duhet të largohet nga auditimi menjëherë dhe duhet të caktohet një senior tjetër në vendin e tij.

Çfardo pune që e ka kryer deri me tash Arbeni, siç është planifikimi i auditimit, duhet të rishikohet dhe të ndryshohet nëse është e nevojshme.

(b) Katrani

Dëshmitë e auditimit

Auditorët duhet të marrin letrat e përfaqësimit në çështjet që janë materiale për pasqyrat financiare atëherë kur dëshmi tjera të mjaftueshme dhe të përshatshme nuk pritet të ekzistojnë. Mirëpo, këto përfaqësime nuk mund të jenë zëvendësim për dëshmitë tjera të auditimit të cilat auditori pret në mënyrë të arsyeshme të ekzistojnë.

Auditori pret që ekzistojnë burim të dëshmive përveç opinionëve të menaxhmentit për çështjen nëse një

pasuri ka humbur në vlerë. Për shembull, menaxhmenti është dashur të bëjë rishikimin e humbjes në vlerë të pasurive, të cilin rishikim auditorët do të mund ta përdorin si dëshmi të auditimit për të kryer verifikimin në supozimet dhe faktet gjatë rishikimit të humbjes në vlerë.

Nëse kjo dëshmi do të ishte në dispozicion, ASKA nuk do të ishte e detyruar të merr një përfaqësim për gudvill. Nëse dëshmi nuk do të ishte në dispozicion, kjo do të përbënte pamundësi në përfundimin e dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, sepse auditorët nuk mund të pranojnë përfaqësimet në lidhje me dëshmitë të auditimit të cilat ata presin të jenë në dispozicion.

Përveç kësaj, nëse dëshmia nuk është në dispozicion, atëherë kjo do të ishte anomaly sa i përket trajtimit

në kontabiliteti, sepse Katrani nuk do të kishte përmbushur kërkesat e SNRF 3.

Raportimi financiar mashtrues

Për shkak të humbjeve të përsëritura, gudvill i Alfa duket se ka humbur në vlerë dhe kërkesat e SNRF 3 nuk janë ndjekur, ekziston një dyshim se në mosnjohjen e humbjes në vlerë në Alfa, ka pasur raportim financiar mashtrues në këtë situatë, veçanërisht pasi që drejtori ekzekutiv është duke pritur përfitime nga kompania përmes ushtrimit të opsioneve.

Mungesa e pavarësisë për shkak të shoqërimit të gjatë

Është e mundur që auditorëve u ka ikur pa i shikuar problemet që janë nënvizuar më lart për shkak të mungesës së pavarësisë që del nga fakti se firma e auditimit ka një shoqërim të gjatë me klientin. Stafi i auditimit ka marrëdhënie personale me Avni Kikën deri në atë masë sa ata besojnë se ai është i ndershëm dhe nuk presin ndonjë keqpërdorim nga ana e tij deri në atë masë sa është dëmtuar skepticizmi profesional i tyre.

Implikimet për dëshmitë e auditimit

Duket se janë marrë dëshmi të pamjaftueshme të auditimit sa i përket gudvill të Alfa dhe në këtë rast edhe për bazën e pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë. Është e mundur se ka dëshmi të pamjaftueshme të auditimit për fusha tjera të auditimit.

Implikimet për vazhdimin e angazhimit

Ky problem nuk ndikon që firma e auditimit të largohet nga auditimi i klientit, por kjo sugjeron se mund të jetë i domosdoshëm rrotacioni i stafit senior që kanë qenë më gjatë të involvuar me klientin. Opinioni i auditimit për vitin 2015 duhet t'i nënshtrohet rishikimit të ftohtë për tu siguruar se janë përftuar dëshmi të mjaftueshme për të bazuar opinion e auditimit.

(c) Korbi

Kërcënimi i avokimit

Kërcënimi i avokimit për pavarësinë ka dalë në pah në momentin kur Korbi është kërcënuar të padis auditorët e ASKA.

Mungesa e integritetit

Nëse paditë janë të vërteta dhe AKSA ka ngarkuar çmime të tepërta ndaj Korbi, kjo tregon mungesë të integritetit nga ana e ASKA. Mirëpo, mund të ishte një gabim i thjeshtë ose ndoshta ASKA ka besuar se kjo është praktikë e industrisë ose ishte një politikë me marrëveshje në letrën e angazhimit në mes të dy palëve.

Pasi që seancat gjyqësore janë të shtrenjta dhe ASKA duket se nuk ka vepruar në mënyrë joligjore, Korbi mund të këshillohet ta dërgojë këtë çështje në komisionin disiplinor të ShKÇAK e jo direkt në gjykatë. Partneri i angazhimit mund ta këshillojë Korbin për këtë gjë edhe pse ka pak mundësi që klienti ta pranojë këtë këshillë nëse beson se firma e auditimit është fajtores.

Veprimet për tu marrë

ASKA duhet të lëshojë një notë krediti për ndryshimin e çmimit për tu përpjekur për ta zgjidhur këtë shkelje.

Implikimet për vazhdimin e angazhimit

Përveç nëse kjo mosmarrëveshje zgjidhet shumë qetë, ASKA nuk është më e pavarur sa i përket auditimit të Korbi dhe duhet të jap dorëheqje për auditimin e këtij viti.

Detyra 2

- (a) SNA 705 *Modifikimet e opinionit në raportin e auditorit të pavarur dhe SNA 706 Paragrafët e theksimit të çështjes dhe paragrafët e çështjeve tjera në raportin e auditorit të pavarur* përfshijnë tekstin e sugjeruar të frazave të modifikuara për t'i përdorur ato kur lëshohen raportet e modifikuara.

Kërkohet

Shpjegoni dhe bëni dallimin në mes të secilit prej termeve të

mëposhtme: (i) 'opinion me rezervë;

(ii) 'mohim i opinionit;

(iii) 'paragrafi i theksimit të çështjes;

(iv) 'paragrafi i çështjeve tjera. **(10 pikë)**

- (b) Ju jeni menaxher i auditimit të Petrit Shpk, që merret me tregti të pajisjeve të kuzhinës. Pasqyrat financiare draft të kompanisë për vitin që përfundon me 31 mars 2016 tregojnë të hyra prej €42.2 milion (2015 – €41.8 milion), fitim para tatimit prej €1.8 milion (2015 - €2.2 milion) dhe gjithsej pasuri prej €30.7 (2015 - €23.4 milion).

Aktualisht jeni duke rishikuar dy çështje nga dosja e letrave të punës së auditimit të Petrit Shpk për vitin që përfundon me 31 mars 2016:

(i) Gjatë vitit Petrit Shpk mori me qira për shtatë vjet (lizing i pa-anulueshëm) një kat të ndërtesës për zyra të kompanisë. Pagesat e lizingut prej €130,000 vjetore paguhën në avans. Vlera e tanishme e pagesave të lizingut është llogaritur të jetë €770,000 dhe është njohur si pasuri nën lizing dhe detyrim nën lizing. Pasuria nën lizing amortizohet për një periudhë shtatë vjeçare. **(5 pikë)**

(ii) Me 1 korrik 2015 Petrit ka prezantuar garancionin 10 vjeçar në të gjitha shitjet e pajisjeve të kuzhinës nga çeliku. Shitjet e pajisjeve të kuzhinës nga çeliku për vitin që përfundon me 31 mars 2016 ishin gjithsej €18.2 milion. Shënimet e pasqyrave financiare shpalosin çështjet në vijim:

'Që nga 1 korriku 2015, pajisjet e kuzhinës nga çeliku garantohen se janë pa defekte në të gjitha materialet dhe puna nëse përdoren normalisht në shtëpi brenda një periudhe prej 10 vjetësh. Nuk është njohur asnjë provizion (lejim) pasi që shumica e obligimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme' **(5 pikë)**

Raporti i auditorit mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 mars 2015 ishte i pa modifikuar.

Kërkohet

Identifikoni dhe kompentoni mbi implikimet e këtyre dy çështjeve për raportin tuaj të auditorit mbi pasqyrat financiare të Petrit Shpk për vitin që përfundon me 31 mars 2016.

Shënim: Supozoni se tani është 19 qershor 2016.

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

- (a) (i) Opinioni me rezervë për pasqyrat financiare jepet kur auditori vjen në përfundim se nuk mund të jepet një opinion pa rezervë por që efekti i çfardo anomalie, ose pamundësi për të përfutur dëshmi të majftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nuk është aq material sa të kërkohej të ipet një opinion i kundërt ose të refuzohet (mohohet) dhënia e
- (ii) Mohimi i opinionit jepet kur efekti i mundshëm i pmundësisë së përfutimit të dëshmive të majftueshme dhe të përshtatshme të auditimit është aq material sa që auditori nuk ishte në gjendje të jap një opinion mbi pasqyrat financiare.
- (iii) Paragrafi i theksimit të çështjes përdoret në një raport të auditimit për të nënvizuar një çështje që ndikon në pasqyrat financiare e cila është paraqitur dhe shpalosur në mënyrë të përshtatshme psh në shënimet e pasqyrave financiare, por që është e një rëndësie të tillë sa që është fundamentale për shfrytëzuesit e pasqyrave financiare. Përfshirja e një paragrafi të tillë të theksimit të çështjes nuk ndikon në opinionin e auditorit mbi pasqyrat financiare. Auditori mund të modifikoj raportin duke përdorur paragrafin e theksimit të çështjes për të raportuar çështjet tjera përveç atyre që ndikojnë pasqyrat
- (iv) Paragrafi i çështjeve tjera është paragraph që përfshihet në raportin e auditorit dhe që i referohet çështjeve tjera përveç atyre të shpalosura në pasqyrat financiare që sipas gjykimit të auditorit janë relevante për shfrytëzuesit e pasqyrave.

Të katër termat mund të dallohet nga njëri tjetri siç vijon:

Paragrafi i theksimit të çështjes ose paragrafi i çështjeve tjera nuk ndikojnë në opinionin e auditorit mbi pasqyrat financiare, deri sa opinion me rezervë dhe mohimi i opinionit ndikojnë. Opinion me rezervë mund të rezultojë nga pamundësia e përfutimit të dëshmive të majftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ose nga anomali të material, deri sa mohimi i opinionit rezulton nga pamundësia e përfutimit të dëshmive të majftueshme dhe të përshtatshme të auditimit që është aq material sa që auditori nuk mund të jap një opinion mbi pasqyrat financiare.

(b)

(i) *Lizingu i pa-anulueshëm*

- Rreziku kryesor është se lizingu është klasifikuar gabimisht si lizing financiar kur është dashur të trajtohet si lizing operativ. Nëse ky është rasti, atëherë pagesat e lizingut është dashur të paraqiten si shpenzime në momentin e ndodhjes.
- Çfardo rrethanash specifike për kompaninë në bazë të të cilave manxhmenti ka dëshiruar ta kapitalizojë lizingun edhe pse ishte lizing operativ.
- Pasuritë e kapitalizuara prej €770,000 përfaqësojnë 2.1% të pasurive totale. Nëse kosto është kapitalizuar në mënyrë jo të duhur atëherë totali i pasurive është keqpohuar në mënyrë material.
- Nëse klasifikimi i gabuar do të çonte në keqohimin e fitimit. Impakti mbi fitimet ka mundësi të madhe të jetë me anomali. Pagesat e lizingut prej €130,000 përfaqëson 4% të fitimit para tatimit të cilat në mënyrë individuale nuk do të vlerësoheshin si material. Përveç kësaj ndikimi i mos ngarkimit të këtyre kostove do të kompenzohej me amortizimin prej €110,000 dhe koston financiare.
- Nëse trajtimi kontabël është në pajtueshmëri me SNK 17. Ky standard kërkon që lizingu financiar të kapitalizohet dhe të njihet detyrimi. Lizingu operativ të shpenzohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë drejtëvizore përgjatë jetës së lizingut.

- Nëse lizingu është financiar apo operativ. Kjo varet nga substance ekonomike e lizingut më shumë se sa forma e sal ligjore e përshkruar në marrëveshje.
- Kushtet e lizingut. Për shembull:
 - Kush është përgjegjës për normat, mirëmbajtjen, riparimet dhe sigurimin.
 - A ka rrethana sipas të cilave titulli ligjor do të transferohet tek Petriti Shpk
 - Nëse Petriti ka të drejtë të jep me qira hapësirën e zyrës
 - Nëse ka opsion të vazhdohet lizingu deri në atë masë sa që Petriti të mund të përdorë atë hapësirë përgjatë pjesës më të madhe jetëgjatësisë së ndërtesës (Afati aktual prej 7 vitesh nuk përbën pjesën më të madhe të jetëgjatësisë së ndërtesës)
- Nëse është aplikuar trajtimi kontabël si duhet (duke supozuar se klasifikimi si lizing financiar është i saktë):
 - Nëse shuma prej €770,000 në fillim është kapitalizuar si një pasuri përfaqëson vlerën e tanishme të pagesave të lizingut në fillim të lizingut.
 - Nëse norma e interest që përfshihet në lizing është përdorur për të llogaritur vlerën e tanishme të pagesave të lizingut
 - Si shpërndahet kosto e financimit përgjatë jetës së lizingur dhe nëse ajo metodë është e pranueshme sipas SNK 17
- Nevoja për të rezervuar raportin e auditimit. Nëse dëshmia tregon se lizingu është dashur të trajtohet si lizing operativ opinion i auditimit duhet të rezervohet me 'përveç për' për mos-pajtueshmëri me SNK 17

(ii) *Garancioni*

Shitja e pajisjeve të kuzhinës nga çeliku përfaqëson €18.2 milion të të hyrave vjetore e cila është 43% e të hyrave gjithsej prandaj është material për pasqyrat. Garancioni megjithatë është paraqitur tre muaj në gjatë këtij viti që do të aplikohet në €13.6 milion të të hyrave që do të përfaqëson 32% të të hyrave.

Kushtet për njohjen e provizionit në pasqyrat financiare në pajtueshmëri me SNK 37

Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente janë këto: ka një detyrim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, është e mundshme se transferimi i përfitimeve ekonomike do të kërkohej për ta paguar obligimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm për vlerën e obligimit.

Menaxhmenti i Petriti Shpk duhet ta njoh një provision në pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 mars 2010 nëse janë plotësuar kushtet. Mirëpo, shpalosja në pasqyra financiare është si një detyrim kontingjent – por ka shumë pak mundësi që kompania të mos mund të bëjë një vlerësim të besueshëm të obligimit.

Nëse nuk është bërë një provision për garancionin atëherë opinioni i auditimit duhet të rezervohet në bazë të anomalisë material (përveç për) sa i përket mos-pajtueshmërisë me kërkesat e SNK 37.

Detyra 3

Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Alfredi ShA, dhe degët e kësaj kompanie. Grupi kryesisht operon një zingjir restoranesesh dhe ofron ushqim me porosi dhe shërbime për klient të korporatave. Të gjitha restoronet ofrojnë ushqim që shërbehet 'në restorant', ushqim që 'merret me vete' dhe 'dërgesa të ushqimit në shtëpi'. Draft pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin që përfundon me 30 shtator 2016 tregojnë të hyra prej €42.2 million (2015 – €41.8 million), fitim para tatimit prej €1.8 million (2015 – €2.2 million) dhe pasuri totale prej €30.7 million (2015 – €23.4 million).

Çështjet në vijim janë shfaqur gjatë auditimit përfundimtar dhe janë shënuar në letrat tuaja të punës për t'i konsideruar:

- (a) Në shtator 2016 bordi i menaxhmentit ka njoftuar planin për të ndërprerë shërbimin e 'dërgesës në shtëpi të ushqimit' nga fundi i muajit. Këto shitje kapin shumën prej €0.6 milion për vitin që përfundon me 30 shtator 2016 (2015 – €0.8 milion). Është bërë një provision (lejim) prej €0.2 milion me 30 shtator 2016 për kompensimin e punëtorëve që do të pushohen nga puna (kryesisht shoferë). Veturat e dërgesave janë klasifikuar si pasuri joqarkulluese të mbajtura për shitje me 30 shtator 2016 dhe janë matur sipas vlerës së drejtë (fer) minus kosto për tu shitur, €0.8 milion (vlera bartëse, €0.5 milion). **(8 pikë)**
- (b) Historikisht, të gjitha pronat e zotëruara janë matur sipas koston të zhvlerësuar për një periudhë prej 10 deri në 50 vjet varësisht nga prona. Bordi i menaxhmentit ka vendosur të ri-vlerësojë këto prona për vitin që përfundon me 30 shtator 2016. Në fund të periudhës raportuese dy nga pronat ishin ri-vlerësuar me një total prej €1.7 milion. 15 pronat tjera që nga atëherë janë ri-vlerësuar me €5.4 milion dhe kanë mbetur 3 prona të cilat pritet të ri-vlerësohen gjatë vitit 2017. Teprica e ri-vlerësimit prej €7.1 milion është kredituar në ekuitet. **(7 pikë)**
- (c) Gjatë vitit Alfredi ka paguar €0.1 milion (2015 – €0.3 milion) në gjoba dhe ndëshkime që kanë të bëjnë me shkeljet e rregulloreve për shëndet dhe siguri në punë. Këto shuma nuk janë shpalosur ndaras po janë përfshirë në kosto të shitjeve. **(5 pikë)**

Kërkohet

Për secilën nga çështjet e mësipërme:

- (i) Komentoni mbi çështjet që duhet të konsiderohen
- (ii) Tregoni për dëshmitë e auditimit të cilat ju pritni t'i gjeni

Gjatë rishikimit të letrave të punës dhe pasqyrave financiare të Alfredi për vitin që përfundon me 30 shtator 2016.

Shënim. Pikët janë alokuar sipas çështjeve individuale të mësipërme. Supozoni se tash është 11 mars 2016.

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

Zgjidhja

(a) Ndërprerja e shërbimit të dërgesës së ushqimit në shtëpi

(i) *Çështjet që duhet të konsiderohen*

- Me 1.4% të të hyrave, të ardhurat nga shërbimi i dërgesës në shtëpi është material për pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse
- Nëse shërbimi i dërgesës në shtëpi kualifikohet si komponentë e biznesit të Alfredit, atëherë kjo do të kualifikohej si operacion i ndërprerë në pajtueshmëri me SNRF 5 dhe do të duhej shpalosje e operacioneve të ndërprera në pasqyrat financiare
- Mirëpo, në mënyrë që të jetë komponentë, operacionet dhe rrjedhat e parasë do të duhej të ishin qartë të dalluara nga pjesa tjetër e entitetit. Nga aspekti operacional, shërbimet e dërgesës në shtëpi nuk mund të ndahen nga pjesa tjetër e operacioneve prandaj nuk përbën ndërprerje të operacionit.
- Provizionet për koston e mbulimit të të punësuarve që humbin punën prej €0.2 milion janë material për pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe përfaqësojnë 11.11% të fitimit para tatimit.
- Auditorët duhet të konsiderojnë kohën e asociuar me koston e kompensimit të punëtorëve të pushuar nga puna për të siguruar se provizionet përmbushin kërkesat e SNK 37, por në divizioni mbyllet në të tërësi deri me 31 shtator, atëherë do të ketë detyrim si rezultat i ngjarjeve të kaluara. Prandaj duket e arsyeshme
- Provizionet duhet të testohet për nënvlerësim
- SNRF 5 thekson se pasuritë duhet të klasifikohen për tu mbajtur për shitje nëse ka shumë mundësi se do të shiten
- 'Ka mundësi të madhe' është sugjeruar nga menaxhmenti duke pasur plane të zotuar për të shitur pasuritë, duke përfshirë plane për të gjetur blerësit, poashtu ka marketing aktiv dhe pritje që pasuritë do të shiten brenda një viti.
- Standardi poashtu thekson se pasuritë që mbahen për shitje duhet të mbahen sipas vlerës më të ulët ose vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në këtë rast, kompania është duke i mbajtur me vlerën e drejtë, e cila është më e lart se vlera bartëse.
- Diferenca në mes të vlerës bartëse dhe vlerës së drejtë nuk është materiale për pasqyrën e pozitës financiare dhe është nën 1% të pasurive.
- Mirëpo, nëse bëhet një regjistrim në anën kreditore të pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse atëherë kjo është material për këtë pasqyrë (16.7% të fitimit) dhe duhet të rezervohet

(ii) *Dëshmitë e auditimit*

- Detajet e vendimit për të mbyllur divizionin (procesverbalet e takimit të bordit/publikimet për shtyp/komunikimet me të punësuarit)

- Pasqyrat menaxheriale dhe tabelat në të cilat tregohet vlera e të hyrave që u janë atribuuar dërgesave në shtëpi
- Kushtet e kompnezimit për të punësuarit që do të largohen (kontratat e punësimit të shoferëve)
- Prova mbi arsyeshmërinë e provizioneve për kompenzim (numri i shoferëve x vitet e punësimit x pagesat për çdo vit të punësimit)
- Detajet e marrëveshjeve për të shitur pasuritë e mbajtura për shitje
- Çfardo të hyra nga shitja krahasuar me vlerën e parashikuar të drejtë
- Inspektimi fizik i veturave të pashitura

(b) **Rivlerësimi**

(i) *Çështjet që duhet të konsiderohen*

- SNK 16 thekson se kur pasuritë rivlerësohen e tërë klasa e atyre pasurive duhet të rivlerësohet
- Është e lejueshme të bëhet rivlerësimi në bazë të bartjes, në mmomentin kur është bërë rivlerësimi, por kompania nuk duhet të bartë pasuritë në klasën e njëjtë bazuar në vlerësime të ndryshme, prandaj të gjitha pasuritë duhet të rivlerësohen ne rastin e parë
- Duket se Alfredi është duke kërkuar të rivlerësoj pasuritë në bazë të bartjes dhe që dy prona janë rivlerësuar dhe 18 prona të tjera do të rivlerësohen gjatë vitit deri me 30 shtator 2016
- Rivlerësimi i cili është bërë pas fundit të vitit do të jetë material për pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2015 sepse paraqet 17.5% të pasurive gjithsej të vitit 2015 dhe pasi që janë edhe tri prona për tu rivlerësuar kjo përqindje do të rritet
- Poashtu edhe ekuiteti do të rritet në mënyrë materiale në pasqyrën e pozitës financiare
- Nëse Alfredi nuk i rivlerëson të gjitha pasuritë në atë klasë në pasqyrën e pozitës financiare, atëherë auditorët duhet ta rezervojnë opinionin e tyre për këtë çështje
- Pasqyrat financiare poshtu duhet të përfshijnë shpalosjet bazuar në SNK 16
 - Data e rivlerësimit
 - Nëse është involvuar vlerësues i pavarur
 - Metodatat dhe supozimet domethënëse të cilat janë aplikuar në vlerësimin e vlerës së drejtë të pasurive
 - Shtrirjen deri në ç'masë është përcaktuar vlera e drejtë duke iu referuar çmimeve që mund të vëzhgohen (janë në dispozicion) në tregun e hapur ose teknikat tjera
 - Vlerën bartëse e cila do të ishte njohur sipas modelit të kostos

- Tepërcën e rivlerësimit, duke treguar ndryshimin për periudhën dhe çfardo ndalese në shpërdarje të saldove tek aksionarët

(ii) *Dëshimitë e auditimit*

- Tabela e kostos së zhvlerëuar të ndërtesave që zotëron kompania
- Llogaritja e ndryshimit në mes të kostos së zhvlerësuar dhe rivlerësimit për pronë
- Raportet e vlerësimit për secilën pronë
- Inspektimi fizik i pronave për konfirmuar gjendjen e tyre
- Shitjet e pasurive të krahasueshme për të verifikuar vlerësimin
- Shpalosjet në pasqyrat financiare

(c) **Shpalosja e ndëshkimeve**

(i) *Çështjet që duhet të konsiderohen*

- €0.1 milion është 5.5% e fitimit para tatimit prandaj është materiale për pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Shuma korresponduese në vitin e kaluar ishte më materiale për fitimin
- Natyra e këtyre ndëshkimeve poashtu mund t'i bëjë materiale nëse paraqitet se janë mos-pajtueshmeri të vazhdueshme me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të rezultojnë me veprime më serioze se sa ndëshkimet
- Shpalosja duhet të jetë konsistente me atë të vitit të kaluar përveç nëse nevojitet ndryshim për të treguar një vështrim të drejtë ose të jetë në përputhje me standardin
- SNK 1 thekson se kur ka zëra në të hyra dhe shpenzime që janë materiale atëherë natyra e tyre duhet të shpaloset ndaras
- Prandaj, këto gjopa duhet të shpalosen ndaras, ose në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse ose përmes një shënimi në pasqyrat financiare
- Arsytet për shkeljet të cilat kanë rezultuar me gjobë
- Sipas SNK 250, auditori duhet të konsideroj nëse efekti i mos-pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret do të ndikojë në pasqyrat financiare dhe efektin e mundshëm të asaj mos-përputhjeje
- Auditorët prandaj duhet të konsiderojnë nëse mos-përputhja me rregulloret e shëndetit dhe sigurisë nga të cilat ka rezultuar gjoba ka ndikim më të madh të mundshëm në pasqyrat financiare, ndoshta në parimin e vijimësisë ose një detyrimi më të madh në të ardhmen
- Nëse auditori beson se mos-pajtueshmëria është me qëllim atëherë këtë çështje duhet ta diskutojë me personat e ngarkuar me qeverisjen
- Nëse shkeljet janë të qëllimshme dhe për qëllim të kursimit të parasë, atëherë kjo mund të klasifikohet si shkelje për shpërlarje të parave

(ii) *Dëshmitë e auditimit*

- Tabela e shumave që përbën totalin prej €0.1 milion dhe shumat më të mëdha të barazohen me librin e arkës

- Rishikimi kundrejt vitit të mëparshëm për të shikuar se nuk ka shmangie të dallueshme që do të rezultojnë me shifra më të ulëta këtë vit
- Korrespondencat nga autoritetet për gjobat, psh lajmërimi për gjobat
- Detajet e politikave të brendshme të kompanisë mbi shëndetin dhe sigurinë
- Përfaqësimet e shkruara për menaxhmentin se nuk ka gjoba/ ndëshkime tjera të cilat nuk janë shpalosur në PF

Detyra 4

Maki Co është një kompani e madhe private. Biznesi i kompanisë është menaxhimi i ngjarjeve të ndryshme, përfshirë organizimin e konferencave, takimeve dhe ngjarjeve tjera festive për kompani të ndryshme. Maki Co është themeluar 10 vite më parë nga Dea Traka dhe motra e saj Bora, të cilat ende posedojnë shumicën e aksioneve të kompanisë. Kompania është rritur shumë shpejtë dhe tani punëson më shumë se 150 të punësuar në 20 zyra.

Ju jeni menaxher në departamentin e këshillimeve biznesore të kompanisë Flaka & Co. Firma juaj është angazhuar të ofroj shërbime të auditimit të brendshëm për Maki Co. Gjatë bisedave fillestare me Dean dhe Borën, keni zbuluar se aktualisht është një ekip i vogël i auditimit të brendshëm nën mbikqyrjen e Lindës, një auditore që është certifikuar rishtasi. Para se ta udhëheqte departamentin e auditimit të brendshëm, Linda ishte menaxhere juniore e financave të kompanisë. Anëtarët e ekipit të auditimit të brendshëm do të ri-emërohen në role të reja në departamentin e financave pasi që firma e juaj të filloj ofrimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm. Maki Co nuk është klient ekzistues i firmës tuaj dhe për të përfutur kuptim të mëtutjeshëm të kompanisë ju keni mbajtur një takim me Lindën. Shënimet nga takimi me Lindën janë të paraqitura më poshtë.

Shënimet e takimit të mbajtur me Linda Pasha me 1 qershor 2016

Ekipi i auditimit të brendshëm i ka tre të punësuar, përfshirë Lindën e cila i raporton drejtorit financiar. Dy auditorët tjerë janë duke mësuar për provimet profesionale për auditor. Ekipi ishte themeluar dy vjet më parë dhe në fillim ishin fokusuar në prezantimin e kontrolleve financiare në tërë zyrat e Maki Co. Nëntë muaj më parë drejtori financiar e kishte udhëzuar ekipin të fokusohen në prezantimin e kontrolleve financiare në mënyrë që të arrihet një kursim i kostove për shkak të problemeve me rrjedhën e parasë së gatshme të kompanisë. Ekipi nuk ka shumë kohë të kryejë teste të kontrolleve financiare as operative.

Gjatë punës së saj, Linda shpesh zbulon politika të menaxhmentit të cilat nuk respektohen dhe në përgjithësi menaxherët e secilit lokacion ngurrojnë të implementojnë kontrolle pasi që dëshirojnë të shmangin burokracinë dhe punët me letra. Si rezultat, rekomandimet e Lindës shpesh nuk janë marrë parasysh.

Para tre javësh, Linda ka zbuluar një mashtrim në njërin nga zyrat derisa ajo rishikonte procedurat që kanë të bëjnë me aprovimin e furnitorëve të rinj dhe pagesave që u bëhen furnitorëve. Mashtrimi ka përfshirë menaxherin e zyrës që autorizon pagesën e faturave të pranuar nga furnitorët fiktiv. Linda e kishte raportuar rastin te drejtori financiar dhe menaxheri ishte larguar nga puna menjëherë. Ky rast kishte alarmuar pronaret e kompanisë se duhet të bëhej diçka në përmirësimin e kontrolleve të kompanisë.

Dea dhe Bora janë duke konsideruar të ndëmarrin masa ligjore kundër auditorit të jashtëm të tyre Manhattan & Co, sepse procedurat e tyre të auditimit nuk e kishin zbuluar këtë mashtrim. Dea dhe Bora janë duke vendosur nëse të themelojnë një komitet të auditimit apo jo. Sipas kornizës rregullative nën të cilën operon Maki Co nuk kërkohet të ketë një komitet të auditimit, por vetëm kërkohet një shpallje në pasqyrat financiare të tyre nëse kompania ka themeluar një komitet të auditimit.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni benefitet specifike për Maki Co të dhënjes me kontratë (outsourcing) të funksionit të auditimit të brendshëm.

(6 pikë)

(b) Shpjegoni ndikimet e mundshme në auditimin e jashtëm të Maki Co nëse merret vendimi për të dhënë me kontratë funksionin e auditimit të brendshëm.

(4 pikë)

(c) Rekomandoni procedurat të cilat mund të përdoren nga firma e juaj për të llogaritur humbjen financiare të Maki Co si rezultat i mashtrimit.

(4 pikë)

(d) Vlerësoni përparësitë dhe pengesat për Maki Co në themelimin e komitetit të auditimit.

(6 pikë)

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Benefitet spacificke për Maki Co të dhënjes me kontratë (outsourcing) të funksionit të auditimit të brendshëm

Kualiteti

Ofruesi i shërbimeve do të ketë personel me kualitet të mirë me përvojë në raportim financiar, teknika të auditimit dhe vetëdije komerciale dhe biznesore. Kjo do të rritë kredibilitetin dhe efikasitetin e punës që kryejnë. Linda, e cila është kualifikuar tash vonë, mund të ketë përvojë të limituar e poashtu edhe anëtarët e ekipit të saj që ende nuk janë kualifikuar mund të mos jenë teknikisht kompetent në të gjitha fushat e auditimit të brendshëm.

Autoriteti/statusi

Komentet e Lindës se shumë nga rekomandimet e saja janë injoruar. Kjo mund të jetë për shkak se është parë se nuk ka status dhe autoritet brenda kompanisë dhe poashtu ajo ishte menaxher junior para se të udhëhiqte funksionin e auditimit të brendshëm. Nëse rekomandimet vijnë nga një burim i pavarur, i cili ka autoritet atëherë rekomandimet ka mundësi të madhe të ndjekën. Ekipi i tanishëm nuk ka pavarësi pasi që janë të punësuar nga drejtori financiar dhe i raportojnë atij. Ekipi mund të mos pajtohet të kritikojë së tepërmi operacionet e funksionit financiar.

Burimet

Duket se funksioni i auditimit të brendshëm në kompani nuk ka burime të mjaftueshme, pasi që janë vetëm tre persona që ofrojnë auditim të brendshëm një një kompani që po rritet me lokacione të shumëfishta. Dhënia me kontratë e këtij funksioni dot ë rrisë menjëherë bazën e burimeve, që do të thotë se më shumë punë mund të kryhet duke filluar menjëherë.

Fokusi/shtrirja e punës

Nga komentet e Lindës, duket se ekipit i mungon fokusi i vazhdueshëm. Ata drejtohen nga drejtori financiar, i cili e ka ndryshuar fokusin nga kontrollët mbi raportimin financiar në kontrollë operacionale dhe duket se ekipi është shumë i vogël për t'i bërë të dyjat. Dhënia me kontratë e funksionit të auditimit të brendshëm do të ofroj aq personel sa është e nevojshme për të mbuluar një gamë të aktiviteteve.

Rialokimi i personelit

Linda dhe pjesa tjetër e ekipit mund të rialokohen në pjesët tjera të biznesit. Ekipi i financave mund të përfitoj nga burimet shtesë nëse kompania vazhdon të rritet. Kontrollët e brendshmëka më shumë mundësi të futen në organizatë pasi që funksioni i financave do të ketë më shumë njohuri dhe përvojë në zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve.

(b) Ndikimi i dhënies me kontratë të AB në auditimin e jashtëm

Ofruesit e auditimit të jashtëm, Manhattan & Co duhet të vlerësojnë ndikimin e marrëveshjes për dhënie me kontratë të funksionit të auditimit të brendshëm duke iu referuar SNA 61 *Përdorimi i I punës së auditorëve të brendshëm*, dhe SNA 402 *Konsideratat e auditimit lidhur me entitetet që përdorin organizata të shërbimeve*. SNA-të kërkojnë që auditorët të përcaktojnë madhësinë e aktivitetit të organizatës që ofron shërbime klientit dhe relavancën që ka kjo për auditimin.

Manhattan & Co duhet të konsideroj në ç'masë mund të mbështeten në punën e e ofruar nga Flaka & Co. ka mundësi të madhe se do të kemi mbështetje më të madhe se më herët në funksionin e auditimit të

brendshëm, e cila do të rritë efikasitetin e auditimit të jashtëm. Tarifat e ngarkuara nga Manhattan & Co mund të ndikohen nga ky fakt. Pasi që Maki ka mungesë të parasë, tarifa mund të jetë faktorë i rëndësishëm për kompaninë.

Auditorët e brendshëm mund të sugjerojnë ndryshime në sistemin e kontabilitetit dhe kontrole.

Kur të ndodhin këto ndryshime, firma e auditorëve të jashtëm do të duhej të dokumentojë dhe vlerësojë procedurat e reja, të cilat mund të marrin kohë.

Mjedisi i kontrollit ka mundësi të përmirësohet me kohë. Kjo do të thotë se Manhattan & Co duhet të ri-

vlerësojë strategjinë e tyre të auditimit, gjë që do të thotë zvogëlim në procedura të pavarura të cilat do të kryhen.

Manhattan & Co duhe të konsiderojë qasjen në të dhënat dhe letrat e punës së Flaka & Co, si informata relevante për auditimin e jashtëm, veçanërisht sa i përket testimit të kontroleve..

(c) Procedurat për të kuantifikuar humbjen financiare

- Rishikimi i procedurës për shtimin në listë të furnitorëve, për të ndihmuar në identifikimin se sa furnitorë janë shtuar nga menaxheri.

- Rishikimi i pagesave të aprovuara nga menaxheri, dhe krahasimi i furnitorëve që janë paguar në aprovimin e tij me listën e furnitorëve të aprovuar. Kjo do të ndihmojë të identifikohen cilëndo furnitorë të paaprovuar që janë paguar dhe shumat e paguara

- Teknikat e ndihmuara nga kompjuteri mund të përdoren për të identifikuar cilëndo furnitorë me të njëjtën llogari bankare me menaxherin dhe pastaj të ndjekin pagesat deri tek ata.

- Rishikimi i plotësisë së pasqyrave të furnitorëve krahasuar me listën e furnitorëve të paguar, pasi që furnitorët fiktiv nuk do të kenë dërguar pasqyra mujore.

- Për secilin furnitorë, mund të përzgjedhet nga një faturë e pranuar dhe të ndjekin detajet deri te porosia e nënshkruar/fletë-pranim. Nëse asnjëra nga këto nuk mund të gjendet, atëherë fatura dhe furnitori ka mundësi të jenë fiktiv.

- Rishikimi i kushteve të sigurimit të paguar nga Maki për të mbuluar rastet e mashtrimit.

Çfardo rimbursimi potencial do të zvogëlojë humbjen e shkaktuar.

- Diskutimi me menaxhmentin, policinë dhe avokatët (duke supozuar se menaxhmenti e ka raportuar mashtrimin) për tu siguruar nëse ndonjë nga vjedhjet mund të rimbursohet nga menaxheri.

(d) Përparësitë dhe pengesat e komitetit të auditimit

Përmirësimi i kredibilitetit të pasqyrave financiare duhet të rezultoj nga aktivitetet e ndryshme të komitetit të auditimit, veçanërisht nga rishikimi i paanshëm i tyre i pasqyrave financiare dhe diskutimi i tyre i çështjeve domethënëse me auditorët e jashtëm.

Opinionin e auditorëve të jashtëm poashtu do të tërheq më shumë besim, pasi që do të jetë transparent se komiteti i auditimit ka monitoruar pavarësinë e auditorëve.

Një mjedis më i fortë i kontrollit do të inkurajohet nga prezenca dhe veprimet e komitetit të auditimit. Fakti që funksioni i auditimit të brendshëm do t'i raportoj komitetit të auditimit e jo drejtorit financiar do të forcojë pavarësinë e tyre brenda kompanisë dhe do të shtojë peshë rekomandimeve të tyre. Thëksim më i madh në kontrole do të ndihmojë në lehtësimin e kryerjes së biznesit dhe do të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut të biznesit dhe mundësinë për mashtrime.

Ky kredibilitet dhe mjedis i kontrollit i përmirësuar mund të jetë i rëndësishëm për kompani të mëdha dhe ato që rriten shpejtë. Maki duket se ka problem me paranë dhe në rast të kërkesës ndaj huadhënësve do të jetë më lehtë dhe me lirë për tu financuar nëse ata perceptojnë se kjo kompani ka qeverisje të mirë të krijuar nga prezenca e komitetit të auditimit.

Përveç kësaj, menaxhmenti mund të vendos nënjë të ardhme të listohet në bursë. Zakonisht është kërkesë e bursave që kompania duhet të ketë komitet të auditimit.

Komiteti i auditimit duhet poashtu të sjellq aftësi të vlefshme, njohuri dhe ekspertizë për kompaninë. Komiteti do të përbëhej nga drejtorët jo-ekzekutiv të cilët do të kenë përvoja të ndryshme biznesore dhe do të jetë i pavarur.

Mirëpo, mund të jetë e vështirë të rekrutohen anëtarë të përshtatshëm të komitetit. Në praktikë, janë vetëm disa njerëz me aftësi dhe përvojë relevante të cilët në të njëjtën kohë janë të pavarur nga kompania dhe që kanë kohë t'i përkoshtohen rolit të tyre si anëtarë të komitetit. Kjo mund të jetë problem për Maki, aktivitetet biznesore të të cilit janë mjaft të specializuara. Por me reklamë të përshtatshme dhe pagesë të arsyeshme mund të tërheqen njerëz për anëtarë të këtij komiteti. Kjo lidhet me pengesën e fundit që është shpenzimi. Anëtarët e komitetit të auditimit duhet të përresin të pranojnë kompensim që është në nivel me ekspertizën e tyre, prandaj tarifat mund të jenë mjaft të larta.

Detyra 5

Tash së voni jeni caktuar të auditoni kompaninë Qelqi, Shpk. Është një biznes që prodhon produkte nga qelqi si gota, vazo etj dhe punëson 100 të punësuar.

Produktet e qelqit kryesisht shiten në dyqane të mëdha me pakicë për xhepa më të thellë, por Qelqi Shpk shet direkt edhe te një numër i shitësve me pakicë më të lirë. Produktet që i shiten dyqaneve më të shtrenjta dizajnohen sipas specifikacioneve të tyre dhe këto produkte nuk mund t'i shiten askujt tjetër.

Kompani ka një departament të vogël të kontabilitetit i cili përbëhet nga shefi i kontabilitetit Zt. Stasi, i cili i raporton direkt drejtorit menaxhues i cili poashtu është aksionari më i madh, Zt. Birqe. Përveç shefit të kontabilitetit departamenti ka edhe një nëpunës të kontabilitetit, Anën. Kanë një sistem të vogël të kontabilitetit në një kompjuter. Ana i fut faturat në kompjuter dhe mban librin e arkës në mënyrë manuale. Zt. Stasi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave për menaxhmentin në bazë mujore dhe pagat, të cilat aprovohen çdo muaj nga Zt. Birqe. Zt. Birqe kontrollon procesin e blerjeve dhe shitjeve, edhe pse ka një asistent i cili përgatit dokumentet dhe komunikon me Anën në departamentin e kontabilitetit.

Auditorët e mëparshëm nuk pranuan të ri-zgjedhen si auditor për vitin vijues për shkak të mosmarrveshjeve me zt. Birqe, por kishin deklaruar se nuk janë në dijeni për ndonjë arsye etike që mund të pengonte firmën tuaj të vepronte si auditor i këtij viti. Ata ju kishin dërguar juve disa letra të punës relevante, ishin takuar me ju dhe ju kishin dhënë disa informata për auditimin. Njëra nga gjërat të cilën e kishin përmendur ata për auditimin është se ata gjithmonë i kishin vlerësuar kontrollet e brendshme si shumë të dobëta.

Kërkohet

(a) Nga skenari i mësipërm identifikoni

(i) Rreziqet e auditimit

(6 pikë)

(ii) Rreziqet e biznesit

(6 pikë)

Që dalin nga përshkrimi i kompanisë Qelqi.

(b) Diskutoni strategjinë e auditimit të cilën mendoni se duhet të adoptohet në auditimin e Qelqi Shpk, duke theksuar arsyet pse keni zgjedhur një strategji të tillë e jo ndonjë tjetër.
(8 pikë)

(Total = 20 pikë)

Zgjidhja

(a) Rreziqet në kompaninë Qelqi

(i) Rreziqet e auditimit

Rreziku i vetëvetishëm

- Biznesi mbështet tepër në një konsumator kryesor i cili në mënyrë domethënëse është më i madh se Qelqi prandaj ka mundësi të madhe që ky konsumator ka forcë të ulë çmimin. Kjo do të ndikojë në të arkëtueshme dhe shitje dhe poashtu edhe në parimin e vijimësisë
- Në nivel të saldoeve, stoqet mund të jenë me rrezik për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme dhe kjo mund të shkaktoj rritje të nivelit të stoqeve të përdorshme. Shumica nga këto stoqe janë të dizajnuara sipas specifikacioneve dhe nuk mund t'i shiten të tjerëve, prandaj edhe kjo mund të shkaktoj nivel të lartë të stoqeve që dalin jashtë përdorimit.
- Biznesi kontrollohet nga një njeri, që mund të ndikojë në parimin e vijimësisë

Rreziku i kontrollit

- Kontrollat gjithmonë në të kaluarën janë vlerësuar si të dobëta.
- Ka mundësi që ka shumë pak ndarje të detyrave, edhe pse menaxhmenti është i involvuar në tërësi sipas stilit autoritarian

Rreziku i zbulimit

- Ju jeni angazhuar tani, prandaj ka mundësi të jetë auditimi i parë. Ky është një rrezik i vetëvetishëm sepse ju nuk do të keni të gjithë njohurinë për biznesin siç do ta kishit për një biznes të cilin e keni audituar disa herë, prandaj rreziku i moszbulimit të anomalive materiale është i lartë

(ii) Rreziqet e biznesit

Rreziqet operative

- Çështja e theksuar më lart të rreziqet e vetëvetishme sa i përket furnizimit të një konsumatori të madh. Kjo do të thotë se konsumatori e kontrollin aktivitetin e biznesit dhe ka më shumë fuqi mbi biznesin se sa që duhet

Rreziqet financiare

- Kompania dominohet nga një person dhe nëse kompani ka nevojë për capital shtesë kjo do të ishte problematike. Ka mundësi që pronari ka dhënë garanci personale për bankat.
- Mungesa e ndarjes së detyrave çon në mundësi më të mëdha për mashtrime dhe keqpërdorim të parasë
- Kompania merret me shitjet e artikujve me vlerë të lartë që kanë rrezik për tu vjedhur

Rreziku i pajtueshmërisë

- Ka një numër të konsiderueshëm të të punësuarve, prandaj ekziston rreziku i mos-pajtueshmërisë me ligjet e punës, pasi që ka pak mundësi që kompania ka përsuar ndonjë ekspert të kësaj lëmie.
- Xhami është product i rrezikshëm për të punuar me të prandaj ka implikime për shëndet dhe siguri.

(b) Strategjia e auditimit

Faza e parë e auditimit do të jetë të kuptuarin e entitetit. Kjo përfshinë dokumentimin dhe konfirmimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Mirëpo, duket se kontrollet do të vlerësohen si jo-efektive, ose ndoshta do të vlerësohen se ka një mbështetje të madhe tek menaxheri kryesor. Prandaj, ka shumë pak mundësi që auditorët të marrin qasjen e kontrollit. Ka më shumë mundësi që auditorët të përdorin qasjen thelbësore të auditimit.

Rreziku

Rreziqet e auditimit dhe biznesit janë diskutuar më lart. Auditorët shpesh përdorin qasjen e rrezikut për një auditim me qasje thelbësore. Kjo mund të jetë ose me qasje përmes rrezikut të auditimit ose rrezikut të biznesit. Zakonisht kjo përfshinë vlerësimin e të dyjave pasi që këto çështje janë të lidhura.

Qasja përmes rrezikut të biznesit shpesh përdoret për kompani të mëdha të cilat kanë kontrolle të forta, kompani të cilat janë mësuar me konceptet e meaxhimit të rrezikut. Në kompani më të vogla ka pak mundësi që auditorët të mbështeten në aftësinë e vetë biznesit për të menaxhuar rrezikun. Prandaj në këto raste auditorët shpesh përdorin qasjen thelbësore. Ka rreziqe të qarta të auditimit tek ky klient. Prandaj është e kuptueshme të përdoret qasja e rrezikut të auditimit dhe të fokusojmë testet e detajuara të auditimit në fushta e biznesit në të cilat ka mundësi të madhe të ka problem.

Qasja thelbësore

Sa i përket testimit të detajeve atëherë dy qasjet mund të ndërmerren. Auditimi mund të bëhet rreth pasqyrës së pozitës financiare ose transaksioneve (qasja e transaksioneve ose ciklike). Qasja ciklike është më e arsyeshme për shkak se

- Kontrollet besohet se janë të dobëta, prandaj ka mundësi thelbësore që transaksionet kanë anomaly.
- Pasyra e pozitës financiare e vitit të kaluar nuk ishte audituar nga firma jonë
- Testimi i transaksioneve do të na jep një pamje më të qartë si operon biznesi dhe do të ngrisë njohurinë tonë mbi biznesin.

Përfundim

Qasja e përshtatshme është qasja e bazuar në rrezikun e auditimit, e kombinuar me qasjen thelbësore ciklike